



PROCESVERBAL IV/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së IV (katërt) për vitin 2024 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 19.04.2024
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës z. Bali Muharremaj
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpallje “Qytetar Nderi” i Komunës së Suharekës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-6343 të datës 28.01.2022;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Suharekës;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve;**
- 7. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-mars 2024;**
- 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm për “Fshatin rekreativ-turistik në Delloc”;**
- 9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm për “Zona Qendër 1”;**
- 10. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zona Qendër 2”;**
- 11. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zona Qendër 3”;**
- 12. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zona Qendër 4”;**

Kryesuesi - zyra e urbanizmit po kërkon që të tërhiqen 4 pika nga rendi i ditës të cilat janë: Zona Qendër 1, Zona Qendër 2, Zona Qendër 3 dhe Zona Qendër 4.

Bulëza Kuçi - a ka ndonjë arsyetim?

Avni Bytyqi - Harta Zonale e parasheh vetëm Zonën Qendër. Nuk i parasheh zona 1,2,3,4 dhe ne jemi konsultuar me ministrinë dhe ministria ka thënë që nuk e kalojnë dhe jemi detyru me i heq dhe mbledhjen e radhës me sjell vetëm Zonën Qendër komplet si tërësi.

Sanie Kuçi Rexhepaj - gjatë hartimit të PZHK-së dhe HZK-së ministria ka qenë jashtëzakonisht strikte në cilat plane ne mund të vazhdojmë pas miratimit të HZK-së. Zona Qendër dihet por lagjet e tjera nuk janë në qendër.

Liridon Fandaj - pika për Dellocin na ka ardhë dhe një herë,arsyeja pse?

Avni Bytyqi - atëherë kur e kemi tërhek nga rendi i ditës dhe nuk e kemi vazhdu,arsyeja është për shkak se ministria e ka kthy dhe ka kërku që të gjitha numrat e parcellave të jenë në vendim.Ne tani i kemi identifikuar dhe të gjitha pronat janë të definuara në vendim.

Kryesuesi - e hedh në votim që të tërhiqen nga rendi i ditës 4 pikat që janë Zona Qendër 1,2,3 dhe 4.

6 për,1 apstenim

Miratohet që pikat të tërhiqen nga rendi i ditës

Sanie Kuçi Rexhepaj - na ka ardhë një shkresë nga FC “Suhareka”dhe besoj e keni pranuar secili nga ne.Nëse është e mundur që në këtë mbledhje të diskutohet si pikë e fundit të të ndryshme.

Dardan Berisha - na ka ardhë në email dhe ju ka drejtuar kryesuesit.

Kryesuesi - mua nuk më ka ardhë një shkresë e tillë.

Dardan Berisha - shkresa është: kërkesë për lirimin e fushës së futbollit dhe të drejta të barabarta me klubet tjera.

Avni Bytyqi - ne mund ta diskutojmë por çështjen e stadiumit të Ballkanit e ka në shfrytëzim një klub sportiv.Ai e menaxhon dhe nuk mund ti përziheni për arsye se ai e ka një kontratë.Nëse doni e marr kontratën dhe e lexojmë nen për nen.

Kryesuesi - seancën e kaluar ne e ndajmë një parcelë për ta dhënë në shfrytëzim mirëpo duhet të formohet komisioni.Andaj kërkoj që të futet në rend dite edhe kjo pikë shtesë për formimin e komisionit.

Armend Krasniqi - Kryesues është edhe një pikë shtesë që ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të një prone.Përshkrimi është i definuar në hartat zonale.

Kryesuesi - Visari tha që qëllimi nuk është i specifikuar për çka dhe sugjeroi që mos të futet në rend dite

Armend Krasniqi - por unë kam kërkesë zyrtare prej Kryetarit.

Avni Bytyqi - pa pas qëllim prona se për çka po jepet nuk mundet me vazhdu me procedurën.

Armend Krasniqi - është destinim përkatës i caktuar prej urbanizmit.

Visar Kuçi - destinimi është për ndërtim.

Kryesuesi - lexon kërkesën ku ndër të tjera në kërkesë thuhet që kjo parcelë gjendet në zonën kadastrale të Reshtanit,pronë e komunale e Suharekës me sipërfaqe 3177 m² dhe është në kuadër të Hartës Zonale me destinim tregti-afarizëm-banim ZSHP 2 dhe pjesërisht infrastrukturë rrugore.A pajtoheni me fut në rend dite?

Urim Suka - për ne si qasje është gabim dhe mendoj që nuk duhet me hy.Trajtone mirë pastaj e kemi si material me kohë dhe dimë çka të flasim.Ndoshta ja vlen me votu por në këtë formë si u interpretu është tepër jo serioze.

Armend Krasniqi - unë mendoj që kërkesa është më se e qartë.

Dardan Berisha - e shqyrtojmë në Asamble dhe nëse ka paqartësi e heqim.

Kryesuesi - e hedh në votim për rend dite pikën shtesë për formimin e komisionit.

Unanimisht Miratohet

Kryesuesi - e hedh në votim për rend dite pikën shtesë për shqyrtimin e kërkesës së KF “Suhareka”

Unanimisht Miratohet

Kryesuesi - e hedh në votim që të futet në rend dite pika për dhënie në shfrytëzim të parcelës.

5 për, 1 kundër Miratohet

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

5 për, 1 apstenim

Miratohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpallje “Qytetar Nderi” i Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron pikën 2 dhe hap debatin.

Urim Suka - rrespekt për Shkurte Fejzën, pa diskutim që ajo një kohë të gjatë na ka relaksu me këngët e veta. Ndoshta e kam gabim por më duket interesant që qytetari i Suharekës mu bë qytetar nderi dhe nuk e di a është e lejueshme ligjërisht. Unë kam mendu që qytetar nderi shpallet dikush jashtë komunës tonë, përndryshe as që e kontestoj.

Avni Bytyqi - nuk ka ndonjë rregullativë ligjore që i rregullon procedurat dhe kriteret se kush ka drejtë Me u shpall qytetar nderi apo kush nuk ka të drejtë. Edhe mua mu duk interesant por arsyeja ka qenë që është banore e Prishtinës.

Sanie Kuçi Rexhepaj - realisht e meriton dhe mendoj që nuk jemi duke kriju një situatë që me mendu dikush tjetër pse Shkurtja e jo pse unë, për shkak se diçka e dallon dhe mendoj që njejtë sikur gjatë luftës e meriton secili luftëtar, e meriton edhe secila nanë që ka gatë për ata luftëtar e secili mjek që i ka trajtu ata ushtar, të njëjtin mesazh e ka dhënë edhe Shkurta përmes këngëve të saj.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-6343 të datës 28.01.2022;

Kryesuesi - e elaboron pikën 3 dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - unë e kam pa një takim që kanë marrë pjesë ende pa u zëvendësuar.

Avni Bytyqi - udhëzimi administrativ i përcakton disa mekanizma dhe shkojnë me automatizëm në KKSB dhe njëri prej tyre është Haki Hoxha përfaqësues i komunitetit islam dhe Qaush Hajdari përfaqësues i policisë. Nuk i kam ftu në KKSB, kanë ardhë dhe nuk kam mujt ti them të dalin jashtë.

Dardan Berisha - ai e ka ngrit dorën kur janë marrë sugjerime.

Avni Bytyqi - kur po i ndërrojmë vendimet, si për KPF, si për KK-në, si për KKSB-në, i bëjmë me qëllim vetëm që ti futim në sistem për pagesë sepse këto shkojnë me automatizëm.

Liridon Fandaj - ne s’kemi asgjë kundër tyre por ne kemi me votu dhe çka nëse nuk kalon?

Urim Suka - e kuptoj sqarimin por mu më pengon kjo qasja që ata kanë ardhë dhe ne sot po vendosim dhe ne po thojmë që s’ka ndodh kurgja. Ata me ardhë para se me vendos ne këtë ndryshim, është gabim.

Sanie Kuçi Rexhepaj - është tejet qesharake çka jemi duke diskutu dhe për mendimin tim një këshill nuk jep vendime por jep këshilla dhe propozime. Më mirë është me qenë një përfaqësues i policisë dhe me tregu ku ka ndodh një rast dhe me u diskutu ajo temë se sa që po diskutojmë pse erdh ai pa e marrë ne vendimin.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

**4 për, 2 apstenime
Miratohet pika 3**

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 4.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Dardan Berisha - ku kanë qenë ndryshimet?

Avni Bytyqi - MAPL e paskan një model të vetin. Ata e kanë kthyer dhe kanë kërkuar që ta përdorim modalitetin e tyre me qëllim që të gjitha Komunitatet e RKS të jenë unik në planin e transparencës.

Kryesuesi - e hedhë në votim pikën 5.

4 për, 2 abstenime
Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - kërkoj sqarim se cila ka me qenë detyra e këtij komisioni dhe a është themelimi i kësaj ndërmarrje?

Avni Bytyqi - siç e përmendi Kryesuesi, qeveria me vendim e ka themelimi Ndërmarrjen Publike “Eko Theranda” për komunën e Suharekës që është 100% aksionar komuna. Ky komision ka kompetencë dhe mandat që të merr dhe të fillon procedurat e organizimit të ndërmarrjes publike lokale me qëllim të themelimit të bordit të drejtorëve. Bordi i drejtorëve do të ketë 4 anëtar që kanë me u përzgjedh me konkurs ndërsa kryeshefin ekzekutiv e zgjedh me konkurs të bordit të drejtorëve. Pas themelimit të dy organeve shumë të rëndësishme NPL bordi i drejtorëve ka për obligim që të bën të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore për NPL “Eko Theanda” duke filluar nga statuti i ndërmarrjes e deri te rregulloret si dhe kodin e etikës. Pas miratimit nga bordi i drejtorëve të gjitha këto dokumente komisioni komunal i aksionarëve ka për detyrim që ta shikojë ligjshmërinë e këtyre akteve që i ka miratu kuvendi me qëllim që NPL “Eko Theranda” të regjistrohet në Qendrën e Biznesit si NPL me përgjegjësi të kufizuar SHA.

Urim Suka - fillimisht është ide e mirë por shpeshherë nuk kemi mujt me jetësi si ide për shkak të nivelit qendror. Do t’ ishte mirë ta kishim me materialin edhe vendimin e ministrisë. Presim që për dallim prej stacionit të autobusëve që të paktën këtu të kemi qasje ku secili subjekt mi pas përfaqësuesit e vet mbi bazën edhe të ndarjes së pushtetit me idenë që me kontribu.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet

Pika 7.

Informata për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-mars 2024;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - kur jemi te raporti i shpenzimit për dallim me vitin që shkoi, pak në përqindje është më mirë por unë mendoj që prap shpenzimi i buxhetit për investime kapitale sidomos duke llogaritur që ju i keni disa kontrata dy vjeçare, len për të dëshiruar. Uroj që ti keni parasysh vërejtjet që i kemi dhënë vjet dhe ky buxhet të shpenzohet më mirë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

5 për, 1 apstenim
Miratohet pika 7

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm për “Fshatin rekreativ-turistik në Delloc”;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ky projekt-vendim ka qenë edhe herën e kaluar por e keni arsyetu dhe mirë që është përfunduar dhe është sjell prapë. Mirëpo shqetësimi im i vetëm është mos raportimi i PZHK-së dhe HZK-së. Kjo është shqetësuese sepse nëne s'i zbatohet këto dokumente pse mos ti raportojmë. Ne jemi organ që marrim vendime për mi fuqizu këto dokumente planifikuese dhe ekzekutivi e ka përgjegjësinë për me raportu.

Urim Suka - kjo që sapo ngriti Sania është tepër serioze dhe unë dua ta fuqizojë këtë. Ka 1 vit që Sania disa herë e ka ngrit si temë dhe e njëjta situatë. Drejtori ndoshta është mirë me dhënë sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 8.

**4 për, 2 apstenime
Miratohet pika 8**

Pika 9 shtesë: Formimi i komisionit;

Kryesuesi - e hap debatin.

Dardan Berisha - sa do të jenë prej kuvendit?

Kryesuesi - 2 janë nga kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile. E hedh në votim pikën 9.

Unanimisht Miratohet

Pika 10 shtesë: Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 9.

**5 për, 1 kundër
Miratohet Pika 10**

Pika 11 shtesë: Shqyrtimi i kërkesës së KF “Suhareka” ;

Sanie Kuçi Rexhepaj - lexon kërkesën e KF “Suhareka” drejtuar Kryesuesit dhe anëtarëve të KPF-së për lejimin e shfrytëzimit të fushës së futbollit me të drejta të barabarta me klubet tjera. Për deri sa na është drejtuar kërkesa neve si anëtar të KPF-së, unë e pashë të arsyeshme me diskutu si çështje dhe ti kthejmë një përgjigje.

Kryesuesi - e dëgjova me vëmendje kërkesën dhe e dua klubin “Suhareka” sikurse edhe klubin “Ballkanin”. Kanë gabu te emri në email dhe mua nuk më ardhë emaili. Si do çoftë ne do t'ia kthejmë një përgjigje. Ia kaloj fjalën Avniut sepse ky e ka përpiluar këtë kontratë dhe e jep sqarimin.

Avni Bytyqi – Unë me Kryetarin e Komunës, kemi pas takim edhe me kryetarin e KF “Suhareka” dhe kryetarin e KF “Ballkani”. Me kontratë ne nuk kemi të drejtë ti përziehemi klubit të futbollit “Ballkani” por klubi i Ballkanit nuk ka të drejtë me ia ndalu asnjë klubit të komunës së Suharekës të drejtën e shfrytëzimit të stadiumit të qytetit për stërvitje por edhe për lojëra. Klubet sportive janë të obliguara që tri ditë para mbajtjes së aktiviteteve sportive zyrtare të bëjnë kërkesë me shkrim te qiramarrësi për mbajtjen e aktiviteteve sportive. Klubin e Suharekës kjo e ka pengun që duhet ti bëjnë kërkesë dhe kanë kërkuar të drejta të barabarta por kjo nuk është e mundur sipas kontratës.

Kryesuesi - ne dalim me një mendim që me ia kthejmë një përgjigje duke u bazuar në kontratë.

Liridon Fandaj - unë nuk propozoj me ia kthyer përgjigjen dhe m' i thënë se ai e ka kontratën sepse realisht nëse ai nuk iu ka përmbajtur kontratës atëherë duhet me iu shkëput kontrata. Ai nuk iu ka përmbajtur kontratës sepse prej 2018 deri 2024 nuk ka pagu asgjë.

Urim Suka - unë mendoj që ne dy klubet tona duhet me i trajtu në nivelin e rrafshit të barabartë. Sikur Ballkanin. Suharekën, Yllin etj. mbi bazën e nivelit të garave. Situata që tash është e krijuar, kur iu ka dhënë Ballkanit fusha në shfrytëzim, klubi Suhareka nuk ka ekzistuar dhe askush nuk e ka ditë që ka me ardhë një situatë kështu. Tash është situatë e re, përtej obligimeve që ka ne duhet trajtojmë Ballkanin si klub që po na bën krenar. Ai e ka një kontratë dhe nëse ai s' do me pagu, unë mendoj që duhet me ia shkëput por nëse i del zot asaj kontrate le ta vazhdon deri në fund sepse është kampion dhe po pretendon me u bë kampion.

Liridon Fandaj - Ballkani është klubi që e kemi trajtu më së miri dhe e kemi subvencionu dhe në fund një obligim nuk e ka krye dhe sot ja mohon një ekipi tjetër stërvitjet.

Labinot Halitjaha - nuk janë të barabartë sepse Ballkani është në ligë të parë dhe ai në ligë të dytë dhe për deri sa ekziston kontrata nuk mund të themi që janë të barabartë.

Dardan Berisha - sa u informova prej një personi që është në FFK, janë vetëm ndeshjet që luhen për pikë. As stërvitje dhe as lojë miqësore nuk kanë të drejtë. Mund nesër të formohen dhe klube tjera dhe bëhet një kaos i madh. Ajo që e pengon klubin Suhareka janë stërvitjet sepse stërvitjet po i zhvillon në Prizren dhe është shpenzim i madh. Unë propozoj që ne si KPF me bisedu edhe një herë me dy klubet sepse në një formë ka kërku ndihmë nga ne. Unë pajtohem me Liridonin sepse ne i kemi ndihmu shumë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - është mirë që dy klubet me pas një takim me ju Kryesues dhe Kryetarin dhe me arrit një marrëveshje gojore.

Avni Bytyqi - çështja e pagesës siç po thotë Liridoni, nëse Drejtoria, Komuna konstaton dhe i rekomandon Kryetarit që nuk ka pagu, Kryetari me automatizëm ia ndërprente kontratat por nëse ai po supozojmë që i ka 0 obligime, Komuna nuk mund të bëjë asgjë.

Agim Bylykbashi - kemi pas një takim me përfaqësues të sporteve dhe ka qenë një propozim i klubit të FC "Suhareka" me shfrytëzua fushën e Samdraxhës. Është mirë të mendohet që nëse ata janë në gjendje me investu, le ta marrin.

Avni Bytyqi - ideja më e mirë është siq tha Dardani.

Kryesuesi - Unë do t'ia bëj një ftesë klubit FC "Suhareka" dhe e bëjmë një bisedë me ta dhe ndërkohë edhe me klubin FC "Ballkani" nëse do të mund të arrijmë një marrëveshje dhe ti kthejmë përgjigje.

Takimi përfundoi: 14:16

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj